

Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin Chieti-Pescara, Itali, në kuadër të Programit Erasmus+.

Kohëzgjatja e mobilitetit:

Studentët do të studiojnë në Universitetin Chieti-Pescara, Itali, gjatë semestrit e parë të vitit akademik 2026-2027.

Kush mund të aplikojë?

- Studentët Bachelor të UMT-së që studiojnë në vitin e dytë dhe të tretë akademik;
- Studentët Master të UMT-së që studiojnë në vitin e parë dhe të dytë akademik;

Nga:

- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës

Lëndët që do të zhvillohen gjatë semestrit të parë në Universitetin Chieti-Pescara, Itali: <https://www.unich.it/international/international-students/courses-held-english>

Gjuha e Mësimdhënies:

Gjuha e mësimdhënies do të zhvillohet në anglisht.

Bursa përfshijnë:

- Mbështetje individuale për studentët. Shuma është 900 €/muaj
- Mbështetje shtesë për shpenzimet e udhëtimit.

Ju mund të përdorni linkun online EACEA për të llogaritur distancën.

http://ec.europa.eu/programmes/erasmusplus/tools/distance_en.htm

Travel distance	Amount per participant
Between 10 and 99 Km	20 Euros
Between 100 and 499 km	180 Euros
Between 500 and 1999 km	275 Euros
Between 2000 and 2999 km	360 Euros
Between 3000 and 3999 km	530 Euros
Between 4000 and 7999 km	820 Euros
8000 km or more	1.500 Euros

Dokumentet për aplikim

1. Kopje të pasaportës
2. Listë Notash
3. Vërtetim Studenti
4. Certifikatë të gjuhës Angleze
5. Learning Agreement

* *Learning Agreement* është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Chieti-Pescara, Itali,, lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë të vitit akademik 2026/2027 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato qëdo të zhvillojë në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “*Learning Agreement*” tek seksioni “*Commitment*” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “*sending university*” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

Afati për aplikime: 30 Prill, 2026

Për të aplikuar, ju lutemi kontaktoni me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al të Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit Metropolitan Tiranë.

UMT ju uron suksese në aplikim tuaj!